Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal
DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL
UPRAVA ZA POLEPRIVREDU, SUMARSTVO I RURALNI RAZVOJ
DEPARTMENT OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

11/ Nr._____/2013
Rahovec,27.05.2013

N J O F T I M

Njoftojmë fermerët e komunës së Rahovecit se MBPZHR, për vitin 2013, për Bujqit e Republikës së Kosovës, bënë:

THIRRJE PËR APLIKIM

Për Pagesa Direkt për kulturat bujqësore (misër, luledielli dhe farë gruri)
për vitin 2013

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural edhe këtë vit do të mbështes mbjelljen pranverore të misrit, luledielli dhe farës së grurit për përmes pagesave direkt për njësi të sipërfaqes së mbjellë. Niveli i mbështetjes planifikohet të jetë 100 euro/ha për misër dhe luledielli, ndërsa 200 euro/ha për farë gruri.

Fermerët që aplikojnë duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- Duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë mbjellë së paku 1 ha tokë me misër në pronësi;
- Të kenë mbjellë së paku 1 ha tokë me luledielli në pronësi;
- Të kenë mbjellë minimum 5 ha dhe maksimum 100 ha me grurë për prodhimin e farës së grurit;
- Parcela e mbjellë me misër ose luledielli, duhet të jetë në minimum 0.20 ha e pandarë;
- Parcela e mbjellë me grurë për prodhimin e farës së grurit, duhet të jetë në minimum 1 ha e pandarë;
- **Fara e mbjellë e grurit duhet të jetë në Listën e Lejuar të Farës;**
- Sipërfaqja e tokës e marrë me qira, duhet të jetë e kontraktuar së paku për një vit;
- Sipërfaqja e tokës e marrë me qira duhet të jetë 1 ha e pandarë;
- Sipërfaqet e mbjella me grurë për farë duhen plotësuar kriteret gjatë inspektimit fushor.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Aplikacioni i plotësuar;
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Kopja e kartelës së xhirollogarisë bankare valide;
- Dëshminë nga kadastra për sipërfaqen e tokës së punueshme ose kopjen e kontratës që dëshmon posedim të tokës bujqësore;
- Kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit (për personat juridik);
- Kontrata për sipërfaqen e marr me qira, duke bashkangjitur fletën poseduese të qiradhënësit;
- Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;
- Dëshminë mbi kategorinë e farës së mbjellë për farë gruri;
- Kontratën me kompaninë prodhuese të farës (vetëm fermerët që aplikojnë për pagesa direke për farë gruri);
- Formularin për sipërfaqet e mbjella për farë gruri (e verifikuar nga MBPZHR, vetëm fermerët që aplikojnë për pagesa direkt për farë gruri).
- Dëshminë për sasinë e grurit të dorëzuar kompanisë prodhuese të farës (t'i bashkëngjitet dokumentacionit pas korrjes së grurit).

Periudha e aplikimit:
Aplikimi zgjatë 45 ditë kalendarike dhe fillon prej momentit të shpalljes publike.
Aplikimi bëhet në zyrat e Drejtorive Komunale për Bujqësi përmes programit SLPIS.
Mënyra e aplikimit:
Të gjithë fermerët fillimisht, gjatë aplikimit janë të obliguar të plotësojnë formularin për regjistrim në Regjistrin e fermerëve, i cili është parakusht për përfitimin e mbështetjes.
Gjatë procedurës së kontrollit, në rast të gjetjes së shkeljeve do të aplikohen masa ndëshkimore, duke u bazuar në nenin 30 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2013 për pagesat direkt në lëmin e bujqësisë.

Sqarim:
Dokumentacioni për aplikim duhet të dorëzohet në dy kopje dhe brenda periudhës së aplikimit. Dorëzimi i dokumentacionit pas përfundimit të afatit të publikuar, nuk do të pranohet për shqyrtim.

D r e j t o r i

_____

Artan Zenuni